

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” Universiteti i Shkodrës, si një institucion i arsimit të lartë, vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.

1. Universiteti i Shkodrës ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Gjithashtu, USH ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj.
2. USH ka për detyrë të japë njohuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesioneve dhe specialitetesh, sipas fushave që mbulon, si dhe të sigurojë arsimim dhe kualifikim të mëtejshëm profesional e shkencor.
3. USH ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës për çdo tip formimi të nivelit të lartë, duke përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet me interes publik apo privat.
4. USH ka për detyrë të plotësojë standardet për të garantuar zhvillimin mësimor e atë shkencor në tri ciklet e studimit që ofron.
5. USH ka për detyrë të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social - ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar, organizuar dhe kryer shërbime kulturore dhe formuese.

